

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA GLOGOC
MUNICIPAL GLOGOC
01 Nr. 463/06-33865
16/07/2024



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



KONTRATË PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

Duke u bazuar në nenin 21 të Ligjit Nr.06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, lidhur me nenin 24 të Rregullores Nr. (QRK) Nr.09/2020, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, neni 8 i ligjit 04/L-076 të Policisë.

Kërkesa e Policisë së Kosovës – Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Nr.01/0378, të datës 01.03.2024, duke u bazuar në Planin Zhvillimor Strategjik të Policisë së Kosovës 2021-2025, objektivin strategjik 3 “Modernizimi dhe standardizimi i infrastrukturës së Policisë së Kosovës” nën-objektivi 3.3 “Definimi i statusit pronësor dhe planifikimi i objekteve policore”

Vendimit të Kuvendit të Komunës Nr.02-Nr.462/01-20701 i datës 29.4.2024, Konfirmimin e ligjshmërisë së aktit të Komunës së Glogocit nga Ministria e Pushtetit Lokal Nr. 020-303/5 të datës 21.6.2024, Kryetari i Komunës dhe Policia e Kosovës - Drejtoria e Përgjithshme e Policisë lidhin kontratë me të cilën përcaktohen të drejtat dhe obligimet e palëve:

Palët kanë rënë në dakord si vijon:

**Neni 1
PALËT**

- I. Komuna e Glogocit, e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës z. Ramiz LLADROVCI, në tekstin në vijim “Dhënësi i pronës në shfrytëzim”, dhe
- II. Policia e Kosovës, adresa në Rr. “Luan Haradinaj” Nr. 101 Prishtinë, i përfaqësuar nga Kolonel Gazmend HOXHA, Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës apo i autorizuari i tij.

Neni 2

QËLLIMI

Në bazë të kësaj kontrate rregullohet shfrytëzimi i pronës komunale, parcelat kadastrale P-70314035-01987-0, vendi i quajtur “Fusha e gjerë”, tokë ndërtimore e klasës të parë, me sipërfaqe prej S=2075 metra katror, pronë e Komunës së Gllogocit dhe objektin me leje ndërtimore 08 nr. 351-1466 të datës 23.6.2010, gjithashtu, pronë komunale, i jepet në shfrytëzim Policisë së Kosovës për ndërtimin e nënstacionit policor në Zonën Kadastrale Komoran.

Neni 3

OBJEKTI

Objekt i kësaj kontrate është shfrytëzimi i parcelës kadastrale P-70314035-01987-0, vendi i quajtur “Fusha e gjerë”, tokë ndërtimore e klasës të parë, me sipërfaqe prej S=2075 metra katror, pronë e Komunës së Gllogocit dhe objektin me leje ndërtimore 08 nr. 351-1466 të datës 23.6.2010, gjithashtu, pronë komunale, i jepet në shfrytëzim Policisë së Kosovës për ndërtimin e nënstacionit policor në Zonën Kadastrale Komoran, për përmbushjen e interesit publik.

Marrësi i pronës në shfrytëzim do ta shfrytëzoj objektin e kontratës për nevojat e Policisë së Kosovës, sipas vendimit të Kuvendit të Komunës së Gllogocit, nr. 02/462-20701 i datës 29.4.2024.

Dhënësi i pronës në shfrytëzim është pronar i pronës se paluajtshme komunale, Certifikatë kadastrale mbi pronësinë të datës 13.03.2024 me numër të lëndës 07942-03-13024, në tekstin në vijim e referuar si “objekti i kontratës”.

Neni 4

KOHËZGJATJA

Dhënësi i pronës së paluajtshme komunale i jep shfrytëzuesit në shfrytëzim pronën e cekur në nenin 1 të kësaj kontrate në kohëzgjatje prej 25 vjet (njëzet e pesë vjet) duke e filluar nga dita e nënshkrimit të kontratës nga palët kontraktuese.

Neni 5

KOMPENSIMI

Marrësi i pronës në shfrytëzim, duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit të Komunës së Gllogocit, shfrytëzimin e pronës me objektet përcjellëse do ta bëj pa kompensim.

Neni 6

OBLIGIMET E PALËVE

1. Komuna në cilësinë e dhënësit obligohet që shfrytëzuesit t’ia lejoj shfrytëzimi e pa penguar të pronës së dhënë në shfrytëzim;
2. PK-ja në cilësinë e shfrytëzuesit obligohet që të kujdeset për pronën e marr në shfrytëzim dhe pas përfundimit të periudhës së shfrytëzimit, t’ia kthej atë të pa dëmtuar te dhënësi në shfrytëzim.



Neni 7
PËRGJEGJËSIA

Është përgjegjësi e shfrytëzuesit që çfarëdo dëmi që mundë t'i shkaktohet pronës gjatë periudhës së shfrytëzimit t'ia kompensoj dhënësit në shfrytëzim.

Neni 8
SHPENZIMET DHE INVESTIMET

1. Të gjitha shpenzimet e shkaktuara gjatë shfrytëzimit të pronës do të mbulohen nga shfrytëzuesi;
2. Shfrytëzuesi nuk mund të bëjë ndërtimet e reja përveç asaj që është përcaktuar në nenin 1 të kësaj kontrate;
3. Investimet për ndërtimin e objekteve dhe çfarëdo investimi tjetër i ndërmarr gjatë periudhës së shfrytëzimit është përgjegjësi e shfrytëzuesit dhe nuk do të kompensohet nga dhënësi në shfrytëzim.

Neni 9
KUFIZIMET

1. Prona e dhënë në shfrytëzim duhet të përdoret vetëm për qëllimin e përcaktuar në nenin 2 të kësaj kontrate;
2. E drejta e shfrytëzimit nuk mund të bartet te subjektet e tjera;
3. Mos respektimi i dispozitave të këtij neni, përbën arsye të mjaftueshme për ndërprerjen e njëanshme të kontratës.

Neni 10
MBIKËQYRJA

Kryetari i Komunës cakton përfaqësues për mbikëqyrjen e realizimit të qëllimit të shfrytëzimit të pronës së cekur në nenin 2 të kontratës.

Neni 11
MOSMARRËVESHJET

Në raste të mosmarrëveshjeve eventuale në mes të palëve kontraktuese, palët pajtohen që mosmarrëveshjet t'i zgjidhin me mirëkuptim të ndërsjellët.

Neni 12
NDËRPRERJA E PARAKOHSHME E KONTRATËS

Ndërprerja e parakohshme e kontratës për shfrytëzim mund të bëhet nga dhënësi i pronës në shfrytëzim, nëse shfrytëzuesi nuk i përmbahet rregullave të kësaj kontrate.



Neni 13
MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Palët do të respektojnë procedurat ligjore, rregulloret për konfidencialitetin dhe mbrojtjen e të dhënave, duke siguruar ruajtjen e informacionit në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 14
KONFLIKTET EVENTUALE


Konfliktet eventuale që mund të paraqiten gjatë zbatimit të kësaj kontrate, të cilat nuk mundë të zgjidhen me marrëveshje, si është e paraparë në nenin 11 të kësaj kontrate, do të zgjidhen nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Neni 15
HYRJA NË FUQI

Kontrata është nënshkruar në dy (2) kopje identike origjinale (nga një kopje në gjuhën shqipe dhe serbe) për secilën palë nënshkruese dhe hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të saj nga të dy palët.


Nënshkruar me datë: 16/07/2024 në: Glllogova


Z. Ramiz LLADROVCI
Kryetari i Komunës Drenas


(nënshkrimi dhe vula)



Kolonel Gazmend HOXHA
Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës


(nënshkrimi dhe vula)



Hyra Pacolli

From: Muhamet Berisha
Sent: July 03, 2024 13:09
To: Hyra Pacolli
Cc: Gazmend Hoxha
Subject: FW: NJOFTIM
Attachments: Dokumentet e skanuara.pdf; Kontratë për shfrytëzim të pronës mes Komuna e Drenasit dhe Policisë së Kosovës, me komente të Zyrës Ligjore.docx

E nderuar te pergatitet drafti pastaj e shikojmë me drejtorin.

Me respekt,

Major Muhamet Berisha

Drejtor i Kabinetit
Kabineti i Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së
Director of Cabinet, Cabinet of General Director of KP
Tel: +383 (0)45 321 689 & 038 50 80 1230
DPP-Prishtinë/Policia e Kosovës
REPUBLIKA E KOSOVËS

From: Vedat Sherifi <vedat.sherifi@KosovoPolice.com>
Sent: July 03, 2024 1:06 PM
To: Muhamet Berisha <muhamet.berisha@KosovoPolice.com>; Blerim Salihu <blerim.salihu@KosovoPolice.com>
Cc: Fehmi Hoti <fehmi.hoti@KosovoPolice.com>; Çlirim Hajdini <clirim.hajdini@KosovoPolice.com>; Adnan Mehmeti <adnan.mehmeti@KosovoPolice.com>; Hamit Rukiqi <hamit.rukiqi@KosovoPolice.com>
Subject: FW: NJOFTIM

Të nderuar

Sektori për Çështje Ligjore I Policisë së Kosovës pas shqyrtimit të përmbajtjes së Kontratës për shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të Komunës konsideron kontrata ka bazë juridike, përkatësisht është në përputhje me dispozitat e nenit 22 të Ligjit Nr.06/L-092 si dhe nenit 25 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Kontrata në përmbajtje është në përputhje edhe me Vendimin e Kuvendit Komunal të Gllogocit Nr.02-Nr.462/01-20701 i datës 29.4.2024, ligjshmëria e së cilit është konfirmuar me shkresën zyrtare Nr. 020-303/5 të datës 21.6.2024 të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.

Me dispozitat e paragrafit 5 të nenit 25 të Rregullores (QRK) Nr.09/2020 Për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, është përcaktuar detyrimi që dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës për raste të veçanta evidentohet në librat kadastrave të Komunës, që nënkupton se me nënshkrimin e Kontratës nga të dy palët kontraktuese kërkohet iniciimi i procedurës për regjistrim në librat e kadastër në Drejtorin për Gjeodezi dhe Kadastër.

Në kontekst të kësaj Sektori për Çështje Ligjore I Policisë së Kosovës, konsideron se Kontrata nuk ka pengesa në aspektin ligjor andaj rekomandojmë që draftin në WORD, në të cilën kemi ndërhyrje teknike nga Sektori për Çështje Ligjore, mund të aprovohet nga autoriteti miratues I Policisë së Kosovës.

Me respekt,

Kap.Vedat Sherifi
Udhëheqës i Njesisë së Çështjeve Ligjore
Sektori për Çështje Ligjore,
DPSÇL-DPP Prishtinë
Tel: ext: 038 504 504 1054

From: Adnan Mehmeti
Sent: June 27, 2024 10:51 AM
To: Çlirim Hajdini <clirim.hajdini@KosovoPolice.com>; Vedat Sherifi <vedat.sherifi@KosovoPolice.com>; Hamit Rukiqi <hamit.rukiqi@KosovoPolice.com>
Subject: FW: NJOFTIM

Me Respekt

Major Adnan MEHMETI

Sektori per Planifikim Strategjik

Drejtoria për Planifikim Strategjik dhe Ceshtje Ligjore

DPP- Prishtinë

Tel mobil : +383-44-298-620

email- adnan.mehmeti@kosovopolice.com

From: Muhamet Berisha
Sent: June 27, 2024 10:00 AM
To: Adnan Mehmeti <adnan.mehmeti@KosovoPolice.com>
Subject: FW: NJOFTIM

Me respekt,

Major Muhamet Berisha
Drejtör i Kabinetit
Kabineti i Drejtorit të Përgjithshëm të PK-së
Director of Cabinet, Cabinet of General Director of KP

Tel: +383 (0)45 321 689 & 038 50 80 1230
DPP-Prishtinë/Policia e Kosovës
REPUBLIKA E KOSOVËS

From: Gazmend Hoxha <gazmend.hoxha@KosovoPolice.com>
Sent: June 27, 2024 8:28 AM
To: Muhamet Berisha <muhamet.berisha@KosovoPolice.com>
Subject: FW: NJOFTIM



Kol. Gazmend HOXHA

Drejtor i Përgjithshëm i
Policisë së Kosovës

DPP, Prishtinë

gazmend.hoxha@KosovoPolice.com

tel. +383 (0) 38 5080 1248

mob. +383 (0) 44 906 800

From: Ramiz Lladrovci <Ramiz.Lladrovci@rks-gov.net>
Sent: June 26, 2024 10:15 AM
To: Gazmend Hoxha <gazmend.hoxha@KosovoPolice.com>
Cc: Xhelal Svecla <Xhelal.Svecla@rks-gov.net>; Driton Morina1 <driton.morina1@KosovoPolice.com>
Subject: NJOFTIM

 You don't often get email from ramiz.lladrovci@rks-gov.net. [Learn why this is important](#)

I nderuari Drejtor i Përgjithshëm, z. Hoxha,

Uroj të jeni mirë dhe punët ju shkojnë mbarë.

Gjeni bashkëngjitur dokumentacionin e procedurës për dhënien e pronës në shfrytëzim të Komunës së Drenasit për Policinë e Kosovës.

1. Konfirmimi i ligjshmërisë nga MAPL
2. Vendimin e Kuvendit të Komunës së Drenasit
3. Propozim vendimi i Kryetarit të Komunës së Drenasit
4. Kërksa e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës
5. Certifikata e Njesisë kadastrale
6. Kopja e planit të Zyrës kadastrale
7. Situacioni i parcelës, zk. Komoran.

Me nderime,

Ramiz Lladrovci

Me Respekt,

Ramiz Lladrovci
Kryetar i Komunës së Drenasit

E-mail: ramiz.lladrovci@rks-gov.net; rlladrovci@gmail.com

Cel:+383 (0) 49 977 999;

Tel:038 200 40 800

Adresa:Rr.Fehmi e Xhevë Lladrovci p.n
13000 Glllogoc-Drenas